



**VENDIM**

**Nr. 11 Datë 30.01.2013**

**PËR**

**LICENSIMIN E SHOQËRISË “FAVINA 1” SH.P.K NE  
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TE ENERGJISE ELEKTRIKE.**

Në mbështetje të neneve 3 pika 31, 8 pika 2, gërma “a”; 9, dhe nenit 45 pika “4”, dhe 48 pika 2, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, neneve 4 pika 1 gërma “ f”, 5 pika 1 gërma “ f” dhe 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. datë .01.2013, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 30.01.2013, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “FAVINA 1” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e Furnizuesit të Tregtimit të Energjisë Elektrike,

**Konstatoi se :**

Aplikimi i shoqërisë “FAVINA 1” Sh.p.k plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE**  
Bordi i Komisionereve



Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të liçensojë shoqërinë “FAVINA 1” Sh.p.k në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol RAMADANI**